




KOMPANIA REGJIONALE PËR MBETURINAVE
"EKOREGJIONI" SH.A. – PRIZREN
Zyra Regjionale



Prizren: 14.10.2024

Bazuar në kompetencat të cilat burojnë nga Statuti dhe Rregulloret e K.R.M. "Ekoregjioni" SH.a.Prizren, në bazë të Ligjit Nr.03/L-212 dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024 për Rregullimin e procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe konform vendimit të Kryeshefit Ekzekutiv të datës 14.10.2024, me nr të protokollit 01-09/436.

SHPALLË këtë:

KONKURS

Për 7 vende të lira pune (me kohë të caktuar në bazë të kontratave të komunës).

Puna Provuese 6 muaj

Vendi i punës : 7 Puntorë Fizik në Ekoregjion.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Puntorë Fizik

- Kryen të gjitha punët fizike në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave, - zbrazjen e kontenjerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre; - Sipas planit operativ dhe urdhëresës së punës bënë fshirjen-pastrimin dhe larjen e rrugëve, apo pastrimin e rrugës dhe trotuareve nga bora dhe akulli, hudhjen e kripës; -Hapjen dhe mbylljen e varrit - Bën larjen e automjeteve - Bënë largimin e qenve dhe maceve të ngordhura dhe vendosjen e tyre në kontenjer; - Është i obliguar që të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve; - Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të kontenjerëve dhe mjeteve të punës; - Kryen edhe punë tjera sipas urdhëresës së udhëheqësit; - Për punën e kryer i përgjigjet Menaxherit të Njësisë dhe Kryepuntorit.

Kriteret e përgjithshme dhe procedura e vlersimit:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit. Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune (provuese në kohë të caktuar dhe mvarësisht nga performanca e të punësuarve dhe nevoja e kompanisë të njejtëve i rregullohet mardhënja e punës).

Procesi i vlersimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe në bazë të vlersimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë. Kandidatët fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlersimit.



Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Kopja e letërnjoftimit,
- Kopja e cërtifikatës - ekstraktit të lindjes,
- Certifikatën shëndetësore sillet (pas konfirmimit të pranimit në punë)
- Dëshmi për përvojën e punës (trust etj/ nëse posedon)
- Zarf me poziten konkurrese dhe me numrin e telefonit /email adresë(për kontakt).

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë dhe atë nga data 14.10.2024 deri më 28.10.2024, ora 16:00.

Dokumentacioni i kërkuar dorëzohet me zarf të mbyllur në protokolin e Kompanisë, (shënohet emri/ mbiemri/ pozita ne te cilen konkuron, nr.telefonit dhe email adresa) në, adresën KRM “Ekoregjioni” SH.A. Rr. Kukesit nr. 10 në Prizren- kopjet e dorzuara nuk kthehen.Kandidatët të cilët i plotësojn kriteret, do të njoftohen me telefon/email për vendin dhe kohën e testit/ intervistës.

Konkursim mundë ta gjeni të publikuar në faqen zyrtare të K.R.M. “Ekoregjioni” Sh.a.Prizren, duke klikuar në: www.ekoregjioni.com.

